
	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> <b>REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA</b> <b>KOMUNA E SUHAREKËS</b> <b>OPSTINA SUVA REKA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA</b>	
---	--	---

<b>Nr:</b>	50/2024 - Nr: Protokoli: 84/2024
<b>Për:</b>	AAB CONSTRUCTION SH.P.K. me adresë në Prishtinë
<b>Nga:</b>	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit: Fatos Kuqi
<b>Lënda:</b>	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës -Refuzohet
<b>Datë:</b>	28.08.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës në mbështetje të nenit 108/A paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: 26.08.2024 nga Operatori Ekonomik: AAB CONSTRUCTION SH.P.K. me adresë në Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i sistemit të ujitjes në Komunën e Suharekës, Mushtisht, Vraniq, Reshtan** me Numër të prokurimit: 624-24-5822-5-2-1 Numër i brendshëm 624-24-51-521 nxjerr këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatori AAB CONSTRUCTION SH.P.K. me adresë në Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: : **Ndërtimi i sistemit të ujitjes në Komunën e Suharekës, Mushtisht, Vraniq, Reshtan** me Numër të prokurimit: 624-24-5822-5-2-1 Numër i brendshëm 624-24-51-521 kundër: (NJOFITIM VENDIMIT TË AK), të datës 20.08.2024 të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

- I. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit të lartcekur.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## ARSYETIM

**AAB CONSTRUCTION SH.P.K** me adresë në **Prishtinë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i sistemit të ujitjes në Komunën e Suharekës, Mushtisht, Vraniq, Reshtan** me Numër të prokurimit: **624-24-5822-5-2-1** Numër i brendshëm: **624-24-51-521**

Kundër (NJOFITIM VENDIMIT TE AK),, të datës: **20.08.2024** të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **26.08.2024** sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,

**Sa i përket pretendimit ankimore nr. 1** - zyrtari përgjegjës i prokurimit të njëjtin pretendim e kualifikon si të pa baze në aspekt ligjor dhe aspekt të gjendjes faktike, pasi që komisioni vlerues i ofertave për këtë procedurë të prokurimit, ka konstatuar se juve si operator Ekonomik në oferte keni prezantuar, Kontrate Pune, me person i cili sipas verifikimit në ATK, i njëjti rezultoi të jete pjesë e stafit përkatësisht drejtorit të kompanisë tjetër e cila është aktive në ARBK

Me ligjin e punës dhe ligjin e administratës tatimore, kontratat e punës para fillimit të punës duhet të deklarohen në ATK, rrjedhimisht menaxheri i projektit i prezantuar në ofertën tuaj as në muajin 07/2024, nuk është i deklaruar si pjesë e stafit tuaj ku ju si OE keni prezantuar kontrata aktive e cila rezultoi të jete fiktive.

Në kontratën e prezantuar nga ju si OE dhe shkresat tjera janë të pershkruara të dhenat e inxhinierit, përkatësisht menaxherit të projektit ku bazuar në dispozitat e nenit 59, të LPP-se detyre dhe përgjegjësi e komisionit vlerues të ofertave është të realizoj, vlerësim, ekzaminim dhe krahasim të ofertave.

Pra ju si OE sipas kontratës së ngarkuar në e-prokurim me inxhinierin të njëjtin e keni prezantuar në çilesi të stafit tuaj i cili në realitet figuron të jete pjesë e stafit përkatësisht drejtor në kompani tjetër ndërsa OE të propozuar për dhënie në oferte kanë prezantuar Kontrata për Punës, në kuptim të parakontrates dhe angazhimit të stafit për projekt për periudhën kontraktues.

Për kësë qeshtësi ekzistojnë vendime të OSHP-se dhe interpretime e opinione të KRPP-se, prandaj komisioni vlerues i ofertave dhe zyrtaret përgjegjës i prokurimit të AK – Komuna Suhareke në përpikëri kanë zbatuar dispozitat ligjore dhe parimet e prokurimit publik.

**Sa i përket pretendimit ankimor nr. 2** - nuk qëndron ngase deklarata për specifikime teknike kërkohet vetëm për produktet në rast kur OE nuk mund të dorëzojë specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimin e kërkuar, (sipas Udhëzuesit Operativ). Situata tjetër është nëse OE-së së rekomanduar për kontratë i mëngon specifikimi teknik.

**Sa i përket pretendimit ankimore nr. 3 – nuk qëndron** ngase grupit të OE-ve të propozuar për dhënie të kontratës bazuar në kërkesën kualifikuese, për menaxherin e projektit të Musli Shala dhe Bekim Bytyqi, të njëjtit në oferte kanë prezantuar KONTRA MBI PUNEN, apo kontratë mbi veprën, ku është përkrahur emri i projektit dhe numri i prokurimit dhe si të tilla korespondojnë me kërkesën kualifikuese të përcaktuar në Dosje të Tenderit, ku AK – Komuna Suhareke, ka lejuar që Operatori Ekonomik mund të lidhe marrëveshje për projektin në fjalë për stafin kyç ku obligimet kontraktuale fillojnë me rastin e lidhjes eventuale të kontratës, prandaj ky pretendim ankimore kualifikohet si i pa bazuar, për dallim nga oferta e juaj.

**Sa i përket pretendimi ankimor nr. 4 - nuk qëndron** ngase AK në DT nuk ka kërkuar që OE biznesin kryesor të ketë në Sektorin e ndërtimitarisë.

**Sa i përket pretendimi ankimor nr. 5 - Sa i përket çështjes së “konfliktit të interesit”** sqarohet si në vijim:

Çështja e “konfliktit të interesit” përmendet vetëm në paragrafin 1.75 të nenit 4 Përkufizimet, si dhe në paragrafin e 1.3 të nenit 65 të LPP-së.

Paragrafi 1.75 i nenit 4 të këtij ligji “konfliktet e interesit” i përkufizon si në vijim:

*“1.75 Konfliktet e interesit - çdo situatë ku anëtarët e personelit të autoritetit kontraktues ose të një ofruesi të shërbimeve të prokurimit që vepron në emër të autoritetit kontraktues që janë të përfshirë në kryerjen e procedurës së prokurimit ose të cilët mund të ndikojnë në rezultatin e asaj procedure kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes personal financiar, ekonomik apo ndonjë interes tjetër që mund të perceptohet për kompromis të paanshmërisë dhe pavarësisë së tyre në kontekstin e procedurës së prokurimit”.*

Sipas paragrafit 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të nenit 65 të këtij ligji, “Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse Operatori i tillë Ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj:

*1.1 ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose*

*1.2 ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjese të këtyre të fundit “.*

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi të AK-së ju mundet të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit

